



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2023:159496

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07041436

P.nr.216/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalii me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Sadriu, në çështjen penale kundër të pandehurit B.P, nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Vjedhje e shërbimeve komunale* nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.861/23 të datës 24.07.2023, jashtë seancës, në mbështetje të nenit 248, par. 1, nën par. 1.4, të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmjetësim, me datë 25.03.2025, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nr. Ref. ND.40/2025 e datës 13.03.2025 e arritur ndërmjet të pandehurit B.P dhe të dëmtuarës Kompania Kosovare er Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.861/23 të datës 24.07.2023.

III.PUSHOHET procedura penale për të pandehurin B.P, i lindur me datë ..., me vendbanim në Vushtrri, rr. "...", nr..., me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Vjedhje e shërbimeve komunale* nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr861/23 të datës 24.07.2023, e ka akuzuar të pandehurin B.P, nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Vjedhje e shërbimeve komunale* nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 13.03.2025 ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilën pala e dëmtuar përmes parashtrësës së datës 13.03.2025 i ka propozuar gjykatës që çështjen penale P.nr. 216/23 ta referoj në procedurë të ndërmjetësimit, ku në lidhje me propozimin është pajtuar edhe prokurori dhe i pandehuri.

Gjykata bazuar në nenin 229 par. 1 të KPRK-së, duke vlerësuar që kjo lëndë penale i përmbush kushtet ligjore që të referohet në ndërmjetësim, me datë 13.03.2025 të njetën e ka referuar për zgjidhje në procedurën e ndërmjetësimit. Kjo pasi që me nenin 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, e që në rastin konkret vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri është përcaktuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të zhvillimit të procedurës në gjykatë kompetente, apo në një organ tjetër kompetent.

Gjykata është njoftuar nga ndërmjetësuesi se palët me datë 13.03.2025, kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim ashtu që janë pajtuar që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësit, andaj edhe gjykata të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata duke pasur parasysh marrëveshjen e arritur të ndërmjetësit në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar, e bazuar në neni 357 par. 1, pika 1.3 ka vendosur si në dispozitiv të pikës 2 dhe 3 të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.216/2023, datë 25.03.2025

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gjyqtari i vetëm gjykues

Teuta Sadriu

Naim Rekalju

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet ankesa (neni 229 par. 6 të KPP-së).